



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETAR I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM  
Nr. 4, Dt. 21.09.2010

*Per shfuqizim te vendimit nr. 23, date 06.08.2007 te K.B.U "Vjose" dhe anulim te lejes per shfrytezim te materialeve inerte ne shtratin lumit Vjose, (ne vend derdhjen e lumit Bence), bashkia Tepelene, subjektit "Ar & B" sh.p.k, Tepelene, me administrator Z. Roland Xhelitaj.*

Ne mbeshtetje te Vendimit Nr.63, Dt. 26.01.2001,"Per procedurat e kerkimit, te shqyrtimit dhe dhenies se autorizimeve, te lejeve dhe koncensioneve, per perdorimin e rezervave ujore", pika 16 e te ciles percakton, afatet brenda te cilave subjekti ka fituar te drejten e perdorimit te nje rezerve ujore duhet te filloj veprimtarine jane ... Per lejet 12 muaj ....., pas ketij afati subjekti humbet te drejten e perdorimit te kesaj rezerve ..., si dhe pikes 2 ne kushtet e "Ndryshimit ose anulimit te lejes", sipas se ciles "Leja anulohet kur subjekti nuk paguan detyrimet financiare dhe nuk rakordon per to me Agjensine e ujit perkatese, brenda nje afati kohor tre muaj", duke qene perpara faktit qe subjekti "Ar & B" sh.p.k., me administrator Z. Roland Xhelitaj, nuk e ka konsumuar te drejten per shfrytezimin e shtratit te lumit Vjose, per nxjerrjen e materialeve inerte (zhavorr) brenda nje viti dhe nuk e ka paguar as siperfaqen e dhene ne shfrytezim, duke vete humbur te drejten e perdorimit te kesaj leje, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr 23, date 06.08.2007 te K.B.U "Vjose" dhe anulim te lejes per shfrytezim te materialeve inerte ne shtratin e lumit Vjose, ( ne vend derdhjen e lumit Bence), bashkia Tepelene, subjektit "Ar & B" sh.p.k, Tepelene, me administrator Z. Roland Xhelitaj.
2. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
3. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI A.U.B "VJOSE"

Ardian DINE



KRYETARI K.B.U "VJOSE"

Hasan HALILI

